



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:248373

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05170417

Ep.nr.288/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Sh.A.(K), me seli në B “B K”, nr..., Ndërtesa e E, kati ..., P, ndaj debitorit R (B) B, nga fshati R, i Komunës së P, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat B. B, në P P.nr./I.Br.422/22, i datës 28.10.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 10.01.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR** prapësimi i debitorit R (B) B, nga fshati R, i Komunës së P, kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat B. B, në P P.nr./I.Br.422/22, i datës 28.10.2022, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në shumën prej 402.61€.
- II. **REFUZOHET I PABAZUAR**, prapësimi i debitorit për pjesën tjetër të detyrimit në të holla dhe **MBETET NË FUQI** Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Privat B. B, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.422/22, i datës 28.10.2022, sa i përket shumës prej 139.43€.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim Sh.A. (K) me seli në B. “B. K”, nr..., Ndërtesa e E....., kati ..., P, me datë 27.10.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagimin furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 23.06.2021 deri me datën 08.10.2022, baza juridike borxh në vlerë prej 542.04€.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrit P.nr./I.Br.422/22, të datës 28.10.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori me datën 08.11.2022, brenda afatit të lejuar ligjor, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor nën arsyetimin se i borxhi që i referohet periudhës 15.05.2013 prej shumës 116.20 euro, gjithashtu propozimi për përmbartim është parashtruar për të gjitha faturat e arritura pas 1 viti sipas ligjit konsiderohen të parashkruara sipas nenit 360 par.1.1 të LMD-së, duke shtuar se kreditori nuk ka dhënë asnjë argument se në bazë të cilës kontratë të lidhur me debitorin i ka bazuar faturat, si dhe debitori nuk është në dijeni me përmbajtjen e faturave, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbartim.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor me datën 16.11.2022 ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar propozimin e debitorit si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove. Në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar edhe pretendimin e debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit pasi që me datën 03.03.2021, debitori ka bërë pagesë në vlerë prej 30.00 euro, me çrast me pagesë vullnetare është e mjaftueshme për tu manifestuar pranimi i borxhit dhe ndërprerja e parashkrimit, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata në procedurën përmbartimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë të urdhrit përmbartimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbartim të datës 28.10.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat B. B, në P, me P.nr./I.Br.422/22, i datës 28.10.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat

afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 23.06.2021 deri me datën 08.10.2022, në shumën prej 542.04 euro për furnizim me energji elektrike.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbartimore është dokument juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbartim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbartim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se: *“Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit për periudhën kohore për të cilën është kërkuar borxhi në propozimin në përmbartim, gjen se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar konform nenit 71 par.1 pika 1.8 të LPP-së.

Gjykata konstaton se kreditori për periudhën 23.06.2021 e deri me 08.10.2022, ka kërkuar nga debitori shumën prej 542.04 euro, në emër të konsumit të energjisë elektrike.

Në ekstraktin afarist janë të përcaktuara shuma e shpenzimeve (debisë) të debitorit dhe shuma e pagesës (kredisë) së bërë nga debitori. Debitori për periudhën e përcaktuar në propozimin për përmbartim rezulton se ka bërë disa pagesa në vlera të ndryshme, dhe atë me datën 11.09.2021 pagesë në shumën prej 50.00 euro, me datën 06.12.2021 pagesë në shumën prej 100.00 euro dhe me datën 22.03.2022 pagesë në shumën prej 250.00 euro, që në total rezulton se ka paguar 400.00 Euro. Andaj, duke marrë për bazë borxhin e akumuluar brenda periudhës së kërkuar në propozimin për përmbartim nga data 23.06.2021 deri me 08.10.2022, në shumën prej 542.04 euro, dhe pagesat e bëra gjatë kësaj periudhe në vlerë prej 400 euro, rrjedhimisht borxhi i mbetur për këtë periudhë kohore rezulton të jetë 142.04 euro, duke zbatuar dispozitën ligjore nga neni 276

par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj”*, në lidhje me nenin 71 par.1 pika 1.8 të LP-së, që përcakton se *“kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurën nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdie gjyqësore ose një ujdie administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër”*.

Duke qenë se debitori ka paguar shumën prej 400 euro, në periudhën për të cilën kërkohet nga kreditori borxhi prej 542.04 euro, atëherë gjykata konstaton se pas llogaritjes së pagesave, borxhi për periudhën 22.03.2021 deri me 08.10.2022, rezulton të jetë 142.04 euro, të cilën shumë detyrohet debitori të ia paguaj kreditorit, ashtu siç ka vendosur gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi urdhrin përmbarimor sa i përket shumës prej 142.04 euro.

Gjykata konstaton se nuk qëndron pretendimi i debitorit se kërkesa e kreditori është parashkruar në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, dhe ky kundërshtim materialo-juridik nuk është marrë për bazë për miratimin e pjesërishëm të prapësimit.

Borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën e specifikuar në propozimin për përmbarim nuk është parashkruar, për faktin se kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim të datës 28.10.2022, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2021 deri me 08.10.2022. kjo për shkak se parashkrimi i borxhit të vitit 2021 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2021 dhe i njëjti do të parashkruhej me 31.12.2022, ndërsa borxhi i vitit 2022, do të parashkruhej me 31.12.2023, kurse kreditori paraqitjen e propozimit për përmbarim e ka bërë brenda afatit ligjor 1 vjeçar të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së.

Paraqitja e propozimit ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Andaj pretendimi i debitorit për parashkrimin e borxhit të kërkuar nga kreditori është i pabazuar.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me

natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 341 par.1 dhe 2, neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:248373
Ep.nr.288/2022, me datë 10.01.2024.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.